



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	01-02-2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot B. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	416/2021		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.444/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.444/2020 të datës 30.12.2020 të parashtruar nga ankuesit:

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë, Rr. Bedri Gjinaj, Hyrja Nr.1, Zyra Nr.3, në Mitrovicë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 29.01.2021, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.444/2020 e datës 30.12.2020, e parashtruar nga ankuesit dhe

### A r s y e t i m

Ankuesit, dhe që të gjithë punëtorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit me datë 30.12.2020 përmes postës kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 3361/2020 të regjistruar me numër A.nr.444/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Më datë 20.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3361/2020 të datës 30.12.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali i parashtrimit të ankesës nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve i datës 30.12.2020; Kërkesa e datës 16.12.2020; Autorizimet për përfaqësim nga ankuesit për Av.

Dosja për punë jashtë orarit e ankueses  
Rrecaj për datat 27.04.2020, 04.05.2020, 18.05.2020; 11.05.2020, 09.03.2020, 16.03.2020, 23.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, Dosja për punë jashtë orarit e ankueses për datat 09.03.2020, 16.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 27.04.2020, 04.05.2020, 11.05.2020; Dosja për punë jashtë orarit e ankueses për datat 09.03.2020, 16.03.2020, 23.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 27.04.2020, 04.05.2020, 11.05.2020, 18.05.2020; Dosja për punë jashtë orarit e ankuesin për datat 09.03.2020, 16.03.2020, 30.03.2020, 06.04.2020, 27.04.2020, 04.05.2020, 11.05.2020, Kërkesa e datës 06.11.2020; Dëftesa për pranimin e dërgesës e datës 06.11.2020; Dërgesa postare Nr. R 9780203; Përgjigja në kërkesë e datës 20.01.2021; Kërkesa për pagesën e orëve shtesë e datës 07.08.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së; Vendimi Nr.112/2020 i datës 19.03.2020; Akt emërimi i datës 03.02.2014 për Akt emërimi i datës 31.01.2013 për Akt emërimi i datës 18.06.2012 për  
Rrecaj; Hyrje-daljet prej 01.03.2020 deri me 31.05.2020 për Hyrje-daljet prej 01.03.2020 deri me 31.05.2020 për  
01.03.2020 deri me 31.05.2020 për Hyrje-daljet prej 01.03.2020 deri me 31.05.2020 për  
31.05.2020 për Hyrje-daljet prej 01.03.2020 deri me 31.05.2020 për

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.444/2020 e datës 30.12.2020, e parashtruar nga ankuesit dhe  
*është e pa lejuar, sepse:*

Ankuesit që  
të gjithë punëtorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit me datë 30.12.2020 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mosrealizimin e kompensimit për punën jashtë orarit me pagesë, për muajt mars, prill dhe maj 2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesit ka konstatuar se ankuesit dhe me kërkesën me numër protokolli 331/20 te datës 07.08.2020 i janë drejtuar Sekretari të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku kane kërkuar realizimin e kompensimit për punën jashtë orarit me pagesë për muajt mars, prill dhe maj 2020, asnjëherë ankuesit nuk kanë pranuar ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën e tyre. Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se në kërkesën e datës 07.08.2020 ankuesit pos tjerash në paragrafin e fundit të kërkesës theksojnë se: "P.S, Kjo kërkesë është dërguar me datën 02.06, tek zyra e U.D. Sekretares, Znj. me numër protokolli 230/20 dhe nuk kemi marr përgjigje, as nuk jemi kompensuar".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafin 1 dhe nenin 81 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me



datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ. Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht kërkesës me numër protokoll 331/20 të datës 07.08.2020 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me realizimin e kompensimit për punën jashtë orarit me pagesë për muajin mars, prill dhe maj te vitit 2020, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 30.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në piken 1 të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.444/2020

Hysni Mustafa  
  
Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari  
  
Kryetare/e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuësve Avokat z.
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHC-së.

